



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" nr.1 Tiranë, Tel: + 355 4 2247294, e-mail klsh@klsh.org.al

Nr. 1051/7 Prot.

Tiranë, më 30/11/2018

V E N D I M

Nr.179, Datë 30/11/ 2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR
NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE "MBI AUDITIMIN E
PASQYRAVE FINANCIARE VJETORE TË INSTITUCIONIT".**
për periudhën nga **data 01.01.2017 deri me datë 31.12.2017.**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë për dhënien e opinionit mbi auditimin e pasqyrave financiare vjetore të institucionit për periudhën e audituar 01.01.2017-31.12.2017, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme jo materiale për të cilën japim opinion të pakualifikuar.

Në programin e auditimit, nuk janë përfshirë procedurat për prokurimet publike.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi auditimin e pasqyrave financiare vjetore të institucionit", të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB),

Tiranë sipas programit të auditimit nr. 1051/1 prot., datë 17.9.2018 për veprimtarinë financiare nga data 01.01.2017-31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion i pakualifikuar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të DPB për vitin ushtrimor 1 janar 2017 deri 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve*) (*pagesave*) në para, pasqyrën e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimin se bilanci, deklarata e të ardhurave, shpenzimeve, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700, dhe ISSAI 1200, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të DPB për periudhën 1 janar 2017 deri 31 dhjetor 2017.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2017, janë evidentuar aktive të qëndrueshme të trupëzuara (Ilog. 212) “Ndërtim rikonstruksione” me vlerë zero për vitin 2017 dhe 303,020,916 lekë të mbartura (progresivi) ndërkohë që DPB, nuk zotëron të tilla. Kjo vlerë trashëgohet prej vitit 2007 pa analiza duke dhënë realisht një pamje të gabuar/fiktive mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandoj: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve t’i kërkojë/propozojë Ministrisë së Drejtësisë, shkarkimin nga kontabiliteti të vlerës 303,020,916 lekë, e cila realisht nuk ekziston fizikisht në institucion.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se *ka mospërputhje midis të dhënave të bilancit dhe akteve të rakordimit*. “Shpenzimet korrente” sipas bilancit paraqiten në vlerën 929,831,851 lekë, kurse sipas akt-rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 933,831,851 lekë ose 4,000,000 lekë më shumë, për të cilën nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 3/1. Në pasqyrat financiare mungon shpjegimi, se përse nuk rakordojnë këto shuma.

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Procesimi i transaksioneve në fund të vitit*” dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Procedura standarde e zbatimit të buxhetit*”, Kreu III, “*Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike*”, nënkaptulli “*Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike*”, ku përcaktohet se:

“Rakordimi mujor i shpenzimeve:

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Formati i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014” pika 34 thekson se “Degët e thesarit gjenerojnë informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatikë të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë në zbatim të manualeve përkatës”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 14-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandoj: Sektori i Financës:

- Të marrë masat e nevojshme për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.

-Të hartoj dhe nënshkruaj rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e DPB dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast. Nëpunësi Zbatues të përgatit raporte periodike tremujore për menaxhimin e lartë, lidhur me nivelin e shpenzimeve të realizuara kundrejt fondeve të akorduara, realizimin e regjistrimit të prokurimeve të parashikuara sipas katër mujorëve, etj.

Periodikisht dhe çdo muaj

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2017 dhe 2018, nuk ishte nxjerrë urdhri për delegimin nga Nëpunësi Autorizues për caktimin e kordinatorit të riskut, Urdhri për hartimin e hartave të proceseve të punës, gjurma e auditit, regjistri i identifikimit dhe kontrollit të risqeve dhe urdhri për ngritjen e GMS, në kundërshtim me nenin 8, 9, 16 të Ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 26-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandoj: Nëpunësi Autorizues të marrë masat e nevojshme për:

- Përditësimin e gjurmës së auditit në përputhje me ndryshimet strukturore.

- Krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) duke bërë ndryshimet e nevojshme.

- Rivlerësimin e regjistrimit mbi identifikimin dhe kontroleve të risqeve, si dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të rivlerësohet dhe matur çdo vit si pjesë e një procesi formal të veprimtarisë së njësisë.

Menjëherë

4. Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit, konstatohet se organizimi dhe veprimtaria administrative e DPB mbështeten në Rregulloren e Brendshme të vitit 2006, e cila nuk është përditësuar pas ndryshimeve strukturore që ka pësuar institucioni në vite, si dhe nuk përmban përshkrimet e punës konform ndryshimeve të reja strukturore.

DPB ka ngritur një grup pune për pasqyrimin e ndryshimeve strukturore në rregullore, por deri në përfundim të auditimit nuk rezulton të jetë miratuar nga Institucioni, në kundërshtim me nenin 29 pika 2 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandoj: Të merren masa për rishikimin e strukturës së institucionit si dhe të bëhen përditësimet në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, duke e plotësuar dhe harmonizuar me kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Menjëherë

5. Në programin e auditimit është përcaktuar se lloji i auditimit është “*Auditimi i pasqyrave financiare*”.

Në programin e auditimit, nuk janë përfshirë procedurat për prokurimet publike. Për këtë arsye i rekomandojmë Institucionit Tuaj, që nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm, të parashikojë dhe realizojë procedurat e prokurimit publik, të zhvilluara gjatë periudhës objekt auditimi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R